



Federata Shqiptare e Futbollit

RREGULLORE E DHOMËS KOMBËTARE TË ZGJIDHJES SË KONFLIKTEVE

Botim zyrtar, 2020

Federata Shqiptare e Futbollit

President:

Armand DUKA

Sekretar i Përgjithshëm:

Ilir SHULKU

Themeluar: 1930

Anëtare e UEFA-s: 1954

Anëtare e FIFA-s: 1930

Realizoi botimin: “Reklama”

PËRMBAJTJA

TITULLI I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	5
KREU 1 – Kompetencat	5
Neni 1 Objekti	5
KREU 2 – Përbërja dhe organizimi	6
Neni 2 Përbërja e DHKZK	6
Neni 3 Organizimi i DHKZK	7
Neni 4 Sekretaria e DHKZK	8
TITULLI II – RREGULLAT PROCEDURALE	9
KREU 1 – Parashikime të përgjithshme	9
Neni 5 Qëllimi i zbatimit: rregullat themelore	9
Neni 6 Selia	9
Neni 7 Gjuha	10
Neni 8 Përfaqësimi	10
Neni 9 Njoftimet dhe komunikimet	10
Neni 10 Afatet kohore	11
Neni 11 Pavarësia e gjyqtarëve të DHKZK	12
Neni 12 Kërkesa për përjashtim	12
Neni 13 Dorëheqja	13
Neni 14 Masat e përkohshme	13
TITULLI III - DISPOZITA TË POSAÇME TË ZBATUESHME PËR PROCEDURËN E ARBITRAZHIT	14
KREU 1 – Arbitrazhi	14
Neni 15 Kërkesa për Arbitrazh	14
Neni 16 Fillimi i arbitrazhit dhe prapësimet	15

TITULLI IV – FORMIMI I TRUPIT GJYKUES	16
KREU 1 – Trupat e arbitrazhit	16
Neni 17 Numri i arbitrave	16
Neni 18 Emërimi i arbitrave	16
Kreu 2 – Pjesëmarrja e personave të tretë në arbitrazh	17
Neni 19 Pjesëmarrja e personave të tretë në proces	17
Neni 20 Pajtimi	17
Neni 21 Konfidencialiteti	17
TITULLI V – PROCEDURAT	19
KREU 1 — Procedurat përpara trupit gjykes	19
Neni 22 Forma e procedimit	19
Neni 23 Seanca dëgjimore	20
Neni 24 Marrja e provës tek të tretët	21
Neni 25 Procedura e përshpejtuar	22
Neni 26 Mosplotësimi i të metave	22
KREU 2 — Gjykimi në themel	22
Neni 27 Ligji i zbatueshëm për themelin	22
Neni 28 Vendimi	22
KREU 3 — E drejta e ankimit	23
Neni 29 Apelimi	23
Neni 30 Përrjashtimi nga përgjegjësia	24
Neni 31 Hyrja në fuqi.....	24
ANEKSI NR.1: TARIFAT E SHERBIMEVE TE DHKZ	24

TITULLI I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU 1 – Kompetencat

Neni 1 Objekti

- 1.1 Dhoma Kombëtare e Zgjidhjes së Konfliktëve këtu e në vijim (DHKZK), është kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile/tregtare që lindin në lidhje nga marrëdhëniet juridike civile të subjekteve që kanë pranuar juridiskionin e Federatës Shqiptare të Futbollit dhe/ose që marrin pjesë në aktivitetet e Federatës Shqiptare të Futbollit, me anë të arbitrazhit dhe/ose ndërmjetësimit, në përputhje me Rregullat Procedurale.
- 1.2 Për këtë qëllim, DHKZK siguron infrastrukturën e nevojshme, emëron Trupat Gjyqësore dhe mbikëqyr zhvillimin e efektshëm të procedurave.
- 1.3 Kompetencat e Trupave Gjyqësore janë, janë:
 - a. të zgjidhin mosmarrëveshjet lidhur me qendrueshmërinë kontraktuale të lojtarëve dhe trajnerëve të futbollit me subjektet anëtare të FSHF ose që marrin pjesë në aktivitetet e organizuara prej sajë që i referohen DHKZK përmes arbitrazhit të zakonshëm;
 - b. të zgjidhin çështjet që lidhen me përcaktimin/konstatimin e statusit të lojtarit sipas “Rregullores për statusin dhe transferimin e lojtarëve” të FSHF;
 - c. të zgjidhin mosmarrëveshjet që lidhen me kompensimin për periudhën e formimit (kompensimin për trajnim);

- d. të zgjidhin mosmarrëveshjet me natyrë civile midis subjekteve anëtare të FSHF ose që marrin pjesë në aktivitetet e organizuara prej saj, që nuk janë kompetencë e organeve të tjera juridike të FSHF.

KREU 2 – Përbërja dhe organizimi

Neni 2 Përbërja e DHKZK

- 2.1 Përbërja e DHKZK përcaktohet nga statuti i FSHF. Anëtarët e DHKZK kanë mandat 4-vjecar me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat tjetër. Rregullorja për procedurën e zgjedhjes së gjyqtarëve miratohet nga Komiteti Ekzekutiv.
- 2.2 FSHF publikon listën gjyqtarëve të DHKZK, si dhe të gjitha ndryshimet e mundshme në të.
- 2.3 Nëse një gjyqtar i DHKZK jep dorëheqjen, vdes ose nuk është në gjendje të kryejë funksionet e tij/saj për ndonjë arsye tjetër, ai/ajo do të zëvendësohet për periudhën e mbetur të mandatit të tij/saj, në përputhje me kushtet e zbatueshme për emërimin e tij/saj.
- 2.4 Gjyqtarët e DHKZK gjykojnë në Trupa Gjykues të përbërë nga secila prej Dhomave të DHKZK.
- 2.5 Pas emërimit të tyre, gjyqtarët e DHKZK nënshkruajnë një deklaratë zyrtare ku marrin përsipër të ushtrojnë funksionet e tyre personalisht me objektivitet, pavarësi dhe paanshmëri të plotë, dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
- 2.6 Gjyqtarët e DHKZK nuk mund të veprojnë si këshilltar/avokat për një palë përpara DHKZK.
- 2.7 Gjyqtarët e DHKZK kanë detyrimin e konfidencialitetit, i cili parashikohet në Rregullore dhe në veçanti nuk duhet t'i zbulojnë ndonjë palë të tretë fakte ose informacione të tjera në lidhje me procedurat e kryera para DHKZK.

- 2.8 Komiteti Ekzekutiv, shkarkon një gjyqtar nga lista e anëtarëve të DHKZK, përkohësisht ose përgjithmonë, nëse ai/ajo shkel ndonjë rregull të këtij Rregullore ose nëse veprimi i tij/saj cënon emrin e mirë të DHKZK dhe/ose FSHF.

Neni 3 Organizimi i DHKZK

- 3.1 DHKZK është e përbërë nga dy dhoma, Dhoma e Arbitrazhit, dhe Dhoma e Statusit të Lojtarit.
- a. **Dhoma e Arbitrazhit** përbëhet nga trupa gjyquese që kanë për objekt gjykimin e mosmarrëveshjeve të parashikuara nga Neni 1.3 Pika a, c dhe d e kësaj Rregullore.
 - b. **Dhoma e Statusit të Lojtarit** përbëhet nga gjyqtarë të vetëm ose trupa gjyquese që kanë për objekt gjykimin e mosmarrëveshjeve të parashikuara nga neni 1.3 Pika b e kësaj Rregullore.
- 3.2 Palët në një procedurë gjykimi kanë të drejtë të kërkojnë që anëtarët e secilës dhomë të përjashtohen nga shqyrtimi i një çështje të caktuar nëse ekzistojnë rrethana që shkaktojnë dyshime të arsyeshme në lidhje me paanesinë e tyre në raport me palët.
- 3.3 Gjyqtarët kanë të drejtën të dorëhiqen paraprakisht, nëse, në procedurën e arbitrazhit ku janë emëruar,
- a. kanë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, personalisht apo si përfaqësues të një pale;
 - b. kanë lidhje gjinie ose krushqie të afërt me palë në gjykim;
 - c. kanë marrëdhënie varësie, miqësie apo konflikte personale me një palë;
 - d. janë ose kanë qenë kreditor/debitor, përfaqësues ligjor të një pale.
 - e. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

- 3.4 Kryetari i DHKZK vendos mbi rastet dhe procedurat e përjashtimit.
- 3.5 Nëse vetë kryetari i DHKZK kërkohet të përjashtohet, funksionet që lidhen me rastet dhe procedurat e përjashtimit, do të kryhen nga zëvendësi i tij.

Neni 4 Sekretaria e DHKZK

- 4.1 Sekretaria e DHKZK ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për të vendosur arbitrazhin në lëvizje. Ajo ia komunikon kërkesën të Paditurit, u bën thirrje palëve të shprehën sipas ligjit të zbatueshëm për bazueshmërinë e mosmarrëveshjes dhe cakton afate kohore.
- 4.2 Sekretaria e DHKZK merr pjesë në të gjitha veprimet për të cilat duhet të mbahet procesverbal.
- 4.3 Sekretaria e DHKZK regjistron çështjet, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga kjo Rregullore ose nga trupi gjykues dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor.

TITULLI II – RREGULLAT PROCEDURALE

KREU 1 – Parashikime të përgjithshme

Neni 5 Qëllimi i zbatimit: rregullat themelore

- 5.1 Kjo Rregullore zbatohet për çdo mosmarrëveshje që i referohet DHKZK në lidhje me:
- a. qendrueshmërinë kontraktuale të lojtarëve dhe trajnerëve të futbollit me subjektet anëtare të FSHF ose që marrin pjesë në aktivitetet e organizuara prej saj e që i referohen DHKZK përmes arbitrazhit të zakonshëm;
 - b. çështjet që lidhen me përcaktimin e statusit të lojtarit sipas “Rregullores për statusin dhe transferimin e lojtarëve” të FSHF;
 - c. mosmarrëveshjet që lidhen me kompensimin për periudhën e formimit (kompensimin për trajnim);
 - d. mosmarrëveshjet që me natyrë sportive midis subjekteve anëtare të FSHF ose që marrin pjesë në aktivitetet e organizuara prej saj, që nuk janë kompetencë e organeve të tjera juridike të FSHF.

Neni 6 Selia

Selia e DHKZK dhe e çdo trupe gjykuese është në Tiranë, pranë selisë së FSHF.

Neni 7 Gjuha

- 7.1 Gjuhët e punës të DHKZK janë; Shqipja dhe Anglishtja.
- 7.2 Në mungesë të marrëveshjes midis palëve, kryetari i trupës gjykuese ose, gjyqtari i vetëm, zgjedh njërën nga këto dy gjuhë si gjuhë arbitrazhi në fillim të procedurës, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse. Pas kësaj, procedurat do të zhvillohen ekskluzivisht në atë gjuhë, përveç nëse palët dhe trupi gjykues bien dakord ndryshe.
- 7.3 Trupi Gjykues gjatë seancës, lejon një palë të përdorë një gjuhë tjetër nga ajo e zgjedhur për arbitrazhin, me kushtin që ajo të sigurojë, me kostot e veta, përkthimin me gojë dhe me shkrim për dokumentat e nevojshme në dhe nga gjuha zyrtare e arbitrazhit.

Neni 8 Përfaqësimi

- 8.1 Palët mund të përfaqësohen nga personat e zgjedhur prej tyre. Emrat, adresat, adresat e postës elektronike, numri i telefonit të personave që përfaqësojnë palët do t'i komunikohen sekretariatit të DHKZK, palës tjetër dhe trupit gjykues.
- 8.2 Përveç kur deklarohet në seancë nga pala, çdo përfaqësues duhet të jetë i pajisur me akt përfaqësimi lëshuar nga vetë pala apo përfaqësuesi ligjor i saj.
- 8.3 Anëtarët e DHKZK, anëtarët e Komitetit Ekzekutiv dhe anëtarët e sekretariatit të përgjithshëm të FSHF, nuk mund të jenë përfaqësues të palëve në proces.

Neni 9 Njoftimet dhe komunikimet

- 9.1 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet që DHKZK ose trupi gjykues kryejnë me palët do të bëhen përmes sekretariatit të DHKZK.

- 9.2 Njoftimet dhe komunikimet dërgohen në adresën elektronike të përcaktuar në kërkesën për arbitrazh, ose në ndonjë adresë tjetër të specifikuar në një datë të mëvonshme.
- 9.3 Të gjitha njoftimet procedurale dhe vendimet e tjera të marra nga DHKZK do të njoftohen me anë të postës elektronike, në mungesë të saj, njoftimi do të kryhet përmes një forme që lejon provën e marrjes.
- 9.4 Në çdo rast, kërkesa origjinale për arbitrazh (kerkesë padia) dhe aktet që i bashkëngjiten, duhet të dorëzohen në sekretarinë e DHKZK nga palët në të paktën tre kopje.
- 9.5 Nëse ato dërgohen paraprakisht me faksimile ose me postë elektronike në adresën zyrtare të e-mailit DHKZK (dhkzk@fshf.al), regjistrimi është i vlefshëm pas marrjes së postës elektronike nga sekretaria e DHKZK.
- 9.6 Shtojcat e bashkëngjitura në çdo korrespondencë me shkrim mund të dërgohen në sekretarinë e DHKZK me postë elektronike, me kusht që ato të jenë të listuara dhe secila shtojcë të identifikohet qartë.

Neni 10 Afatet kohore

- 10.1 Afatet e përcaktuara në bazë të kësaj Rregullore fillojnë të llogariten nga e nesërmja e marrjes së njoftimit nga DHKZK.
- 10.2 Festat zyrtare dhe ditët e pushimit përfshihen në llogaritjen e afateve kohore. Afatet kohore të përcaktuara sipas kësaj Rregullore, konsiderohen të respektuara nëse komunikimet nga palët dërgohen para mesnatës, në ditën e fundit në të cilën mbaron afati kohor.
- 10.3 Nëse dita e fundit e afatit kohor është një festë zyrtare ose një ditë pushimi zyrtar në Republikën e Shqipërisë, afati përfundon në fund të ditës së parë pasuese të punës.
- 10.4 Përjashtimisht dhe vetëm për shkaqe të arsyeshme, pas konsultimit me palët, kryetari i trupit gjykues ose, nëse ai ende

nuk është emëruar, kryetari i DHKZK, mund të zgjasë afatet e parashikuara në këtë Rregullore, nëse rrethanat e lejojnë dhe me kusht që afati që kërkohet të zgjatet të mos ketë përfunduar.

Neni 11 Pavarësia e gjyqtarëve të DHKZK

Çdo gjyqtar i DHKZK do të jetë dhe do të mbetet i paanshëm e i pavarur nga palët dhe do të deklarojë menjëherë çdo rrethanë që mund të ndikojë në pavarësinë e tij/saj në lidhje me cilëndo nga palët.

Neni 12 Kërkesa për përjashtim

- 12.1 Palët mund të kërkojnë përjashtimin e një gjyqtari nëse rrethanat krijojnë dyshime legjitime mbi pavarësinë e tij/saj ose mbi paanshmërinë e tij/saj, sipas kriterëve të vendosura në nenin 3 të kësaj Rregulloreje. Kërkesa duhet të paraqitet tre ditëve nga njohja e emrit të gjyqtarit ose zbulimit të shkakut të përjashtimit.
- 12.2 Kërkesa për përjashtim duhet të paraqitet nga pala që e ngre atë, në formë shkresore drejtuar sekretariatit të DHKZK dhe duhet të përmbajë shkaqet e përjashtimit, dokumentet e provat e tjera që mbështesin kërkesën.
- 12.3 Kërkesat për përjashtim gjykohen nga kryetari i DHKZK. Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankim vetëm për efekt të kundërshtimit të vendimit përfundimtar sipas kufizimeve të vendosura në Kodin e Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë apo në ligj të tjera, në lidhje me kriteret për caktimin e Gjykatës së Arbitrazhit.

Neni 13 Dorëheqja

Gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të DHKZK zëvendësimin e tij. Kryetari i DHKZK, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër.

Neni 14 Masat e përkohshme

- 14.1 Me kërkesën e njërës palë, DHKZK, brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave të përkohshme, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i një të drejte apo i vendimit përfundimtar do të bëhet i pamundur ose i vështirë.
- 14.2 Kërkesa për masa të përkohshme mund të bëhet në çdo fazë të gjykimit, derisa nuk është shpallur ende vendimi përfundimtar.
- 14.3 Kërkesa, si rregull, shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të veçanta ose të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur pala tjetër.
- 14.4 Vendimi për masën është i ekzekutueshëm menjëherë, sipas rregullave për ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit.
- 14.5 Në cdo kohë trupi gjykues me kërkesë të palëve, kur provohet se kanë ndryshuar rrethanat në të cilat u dha masa, mund të vendosë ndryshimin ose revokimin e masës. Vendimi për ndryshimin ose revokimin e masës është i ekzekutueshëm menjëherë, sipas rregullave për ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit

TITULLI III - DISPOZITA TË POSAÇME TË ZBATUESHME PËR PROCEDURËN E ARBITRAZHIT

KREU 1 – Arbitrazhi

Neni 15 Kërkesa për Arbitrazh

- 15.1 Pala që synon të paraqesë një çështje në arbitrazh sipas kësaj Rregulloreje (paditësi) do të paraqesë një kërkesë në sekretariat-in e DHKZK e cila përmban:
- a. emrin dhe adresën e plotë të të palëve dhe përfaqësueve të tyre;
 - b. një deklaratë të shkurtër të fakteve dhe argumentimit lig-jor, përfshirë një deklaratë të çështjes që duhet t'i paraqitet DHKZK për përcaktim;
 - c. kërkesën e tij për masa të përkohshme (nëse ka);
 - d. një kopje të kontratës që përmban marrëveshjen e arbi-trazhit ose të ndonjë dokumenti që parashikon arbitrazh, në përputhje me këto Rregulla Procedurale;
 - e. të gjitha dokumentat që kërkohen të merren në konsideratë nga trupi gjykues si prova;
 - f. çdo informacion të rëndësishëm në lidhje me numrin dhe zgjedhjen e arbitrit (arbitrave); nëse marrëveshja përkatëse e arbitrazhit parashikon tre arbitra, emrin e arbitrit nga lista DHKZK e arbitrave të zgjedhur nga pa-ditësi.

- 15.2 Pas paraqitjes së kërkesës së tij, paditësi paguan tarifën e gjyqësore të parashikuar në Aneksin Nr.1 që i bashkëlidhet kësaj Rregullore.
- 15.3 Nëse kërkesat e lartpërmendura nuk përmbushen kur paraqitet kërkesa për arbitrazh, sekretaria e DHKZK mund t'i japë vetëm një herë, një afat maksimal prej 5 ditë paditësit për të plotësuar të metat, në rast të kundërt çështja do të konsiderohet se nuk është paraqitur.

Neni 16 Fillimi i arbitrazhit dhe prapësimet

- 16.1 I padituri mund të kërkojë që afati i paraqitjes së prapësimeve të përcaktohet pas pagesës nga paditësi i pjesës së tij në parapagimin e kostove.
- 16.2 Trupi gjykues vendos mbi juridiksionin e tij, përveç nëse arsyet thelbësore diktojnë pezullimin e procedurës.
- 16.3 Kur ngrihet një kundërshtim për juridiksionin DHKZK, sekretaria e DHKZK ose trupi gjykues, nëse është krijuar tashmë, do t'i ftojë palët të paraqesin parashtresa me shkrim mbi juridiksionin. Trupi gjykues vendos mbi juridiksionin në cdo fazë të gjykimit..

TITULLI IV – FORMIMI I TRUPIT GJYKUES

KREU 1 – Trupat e arbitrazhit

Neni 17 Numri i arbitrave

Trupi gjykues përbëhet nga një ose tre arbitra. Nëse palët, në marrëveshjen/kontratën objekt gjykimi nuk kanë përcaktuar ndryshe, kryetari i DHKZK përcakton numrin, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes.

Neni 18 Emërimi i arbitrave

- 18.1 Palët mund të bien dakord për mënyrën e emërimit të arbitrave nga lista DHKZK. Në mungesë të marrëveshjes, gjyqtarët do të emërohen në përputhje me paragrafët e mëposhtëm.
- 18.2 DHKZK do të mblidhet, si rregull, me një trupë gjykuese prej tre anëtarësh;
- 18.3 Kryetari i DHKZK dhe dy nënkryetarët do të shërbejnë, si rregull, si kryetarë të trupave gjykuese përkatëse;
- 18.4 Në çdo rast, numri i anëtarëve përfaqësues të klubeve duhet të jetë i barabartë me numrin e anëtarëve përfaqësues të lojtarëve;
- 18.5 Anëtarët e trupave gjykuese, do të zgjidhen me short;

Kreu 2 – Pjesëmarrja e personave të tretë në arbitrazh

Neni 19 Pjesëmarrja e personave të tretë në proces

- 19.1 Nëse një palë e tretë dëshiron të marrë pjesë si palë në arbitrazh, ajo do të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së DHKZK, së bashku me arsyet, brenda 5 ditëve pasi arbitrazhit i është bërë i njohur ndërhyrësit, me kusht që kërkesa të paraqitet para seancës dëgjimore.
- 19.2 Sekretaria e DHKZK do t'i komunikojë palëve një kopje të kësaj kërkesë dhe do të përcaktojë një afat 5ditor që ato të shprehin qëndrimin e tyre për pjesëmarrjen e palës së tretë dhe të paraqesin, në masën e zbatueshme, një qëndrim lidhur me ndërhyrjen.
- 19.3 Një palë e tretë mund të marrë pjesë në arbitrazh vetëm nëse është e lidhur me marrëveshjen e arbitrazhit ose nëse ajo dhe palët e tjera bien dakord me shkrim.
- 19.4 Pas mbarimit të afatit të përcaktuar në Nenin 17.2, kryetari i DHKZK ose trupit gjykues, nëse është emëruar tashmë, vendos për pjesëmarrjen e palës së tretë, duke marrë parasysh, veçanërisht, ekzistencën në *prima facie* të një marrëveshje arbitrazhi.
- 19.5 Nëse kryetari i DHKZK pranon pjesëmarrjen e palës së tretë, DHKZK do të vazhdojë me formimin e trupit gjykues në përputhje me numrin e arbitrave dhe mënyrën e emërimit të pajtuar nga të gjitha palët.
- 19.6 Pas shqyrtimit të parashtrësave nga të gjitha palët e interesuara, trupi gjykues përcakton statusin e palës së tretë dhe të drejtat e saj në procedurë.

Neni 20 Pajtimi

- 20.1 Është detyrë e DHKZK që të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje.
- 20.2 Në çdo fazë të gjykimit, me pëlqimin e palëve, zgjidhja e mosmarrëveshjes me mirëkuptim mund të përfshihet në një vendim të DHKZK.

Neni 21 Konfidencialiteti

- 21.1 Procedurat që zhvillohen sipas kësaj Rregulloreje janë konfidenciale. Palët, anëtarët e trupit gjykues dhe sekretaria e DHKZK marrin përsipër të mos zbulojnë para palëve të treta asnjë fakt ose informacion tjetër në lidhje me mosmarrëveshjen ose procedurat.
- 21.2 Përveçse kur të gjitha palët bien dakord, vendimet nuk do të bëhen publike.

TITULLI V – PROCEDURAT

KREU 1 — Procedurat përpara trupit gjykues

Neni 22 Forma e procedimit

- 22.1 Gjykimi përpara trupit gjykues konsiston, në parim, në parashtrësas me shkrim dhe seancën dëgjimore.
- 22.2 Pas marrjes së çështjes, nëse është e nevojshme, kryetari i trupit gjykues nxjerr udhëzime në lidhje me parashtrësas me shkrim.
- 22.3 Si rregull i përgjithshëm, do të ketë një parashtrësë (padiësi), një prapësim (i padituri) dhe, nëse rrethanat e kërkojnë, një kundërpërgjigje dhe një përgjigje e dytë.
- 22.4 Palët, në parashtrimet me shkrim, mund të ngrenë pretendime që nuk përmbahen në kërkesën për arbitrazh dhe në prapësimet. Pas kësaj, asnjë palë nuk mund të ngrejë ndonjë padi të re pa pëlqimin e palës tjetër.
- 22.5 Së bashku me parashtrësas e tyre me shkrim, palët duhet të paraqesin të gjitha provat me shkrim në të cilat do të mbështeten. Pas shkëmbimit të parashtrësasve me shkrim, palët nuk mund të paraqesin prova të mëtejshme me shkrim, përveçse me marrëveshje të ndërsjellë, ose nëse trupi gjykues e lejon, në bazë të rrethanave të jashtëzakonshme.
- 22.6 Në kërkesën për arbitrazh (padinë) ose parashtrësas e tyre me shkrim, palët do të shënojnë emrin e çdo dëshmitari, të cilin ata duan të thërrasin, duke përfshirë një përmbledhje të shkurtër të dëshmisë së tyre të pritshme, dhe emrin e çdo eksperti, duke deklaruar fushën e tyre të ekspertizës, dhe do

të deklarojnë çdo masë tjetër provuese që ata kërkojnë. Çdo deklaratë e dëshmitarëve do të depozitohet së bashku me parashtrirat e palëve, përveç nëse kryetari i trupit gjykues vendos ndryshe.

- 22.7 Nëse është ngritur një kundërpadi dhe/ose një kundërshtim juridiksional, sekretaria e DHKZK cakton një afat deri në 5 ditë që paditësi të paraqesë përgjigje për kundërpadinë dhe/ose kundërshtimin juridiksional.

Neni 23 Seanca dëgjimore

- 23.1 Nëse do të mbahet seanca dëgjimore, kryetari i trupit gjykues nxjerr udhëzime në lidhje me seancën sa më shpejt të jetë e mundur dhe cakton datën e seancës dëgjimore. Si rregull i përgjithshëm, do të ketë një seancë gjatë së cilës trupi gjykues dëgjon palët, çdo dëshmitar dhe çdo ekspert, si dhe argumentet verbale përfundimtare të palëve, për të cilat i padituri dëgjohej i fundit.
- 23.2 Kryetari i trupit gjykues do të zhvillojë seancën duke siguruar që deklaratat e bëra të jenë koncize dhe fokusuar tek objekti i mosmarrëveshjes.
- 23.3 Me përjashtim kur të gjitha palët bien dakord ndryshe, seancat dëgjimore nuk janë publike.
- 23.4 Seanca dëgjimore mund të regjistrohet. Çdo person i dëgjuar nga trupi gjykues mund të asistohet nga një përkthyes me koston e palës që e ka thirr atë person.
- 23.5 Palët mund të thërrasin vetëm dëshmitarë dhe ekspertë të tillë që ata kanë përcaktuar në parashtrirat apo prapësimet e tyre me shkrim. Secila palë është përgjegjëse për disponueshmërinë dhe koston e dëshmitarëve dhe ekspertëve që ajo ka thirrur.
- 23.6 Kryetari i trupit gjykues mund të vendosë që të zhvillojë një seancë dëgjimore përmes video-konferencës ose të dëgjojë disa palë, dëshmitarë dhe ekspertë përmes tele-konferencës

- ose video-konferencës. Me marrëveshjen e palëve, ai/ajo mund të përjashtojë një dëshmitar ose ekspert nga paraqitja në seancë nëse dëshmitari ose eksperti më parë ka paraqitur një deklaratë.
- 23.7 Trupi gjykues mund të kufizojë ose të mos lejojë paraqitjen e ndonjë dëshmitari ose eksperti, ose ndonjë pjese të dëshmisë së tyre, për shkak të rëndësisë.
- 23.8 Para se të dëgjojë ndonjë dëshmitar, ekspert ose përkthyes, trupi gjykues do ta ftojë në mënyrë solemne një person të tillë të tregojë të vërtetën, duke iu nënshtruar sanksioneve në rast dëshmie të rremë apo mungese bashkëpunimi.
- 23.9 Nëse ndonjë nga palët, ose dëshmitarët është thirrur sipas rregullave dhe nuk paraqitet në seancë, trupi gjykues mund të vazhdojë me seancën dëgjimore dhe të japë një vendim.
- 23.10 Pasi seanca mbyllet, palët nuk mund të paraqesin deklarata të mëtejshme me shkrim, përveç nëse e urdhëron trupi gjykues. Pas konsultimit me palët, trupi gjykues, nëse vlerëson se shpjegimet dhe dokumentet e palëve janë të qarta, vendos të procedojë mbi bazë dokumentesh, pa zhvilluar seancë me pjesëmarrjen e palëve.

Neni 24 Marrja e provës tek të tretët

- 24.1 Trupi gjykues, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj.
- 24.2 Në këtë rast trupi gjykues jep udhëzimet e nevojshme për kohën, vendin dhe mënyrën e paraqitjes së tyre. Pala që ka kërkuar marrjen e dokumentit është e detyruar të tregojë me hollësi të gjitha rrethanat që bëjnë të besueshme se ku ndodhet dokumenti, karakteristikat e tij, si dhe faktet që do të provohen me këtë dokument.

- 24.3 Shpenzimet e nevojshme parapagohen nga pala që ka bërë kërkesën.

Neni 25 Procedura e përshpejtuar

Me pëlqimin e palëve, kryetari i DHKZK ose i trupit gjykues mund të procedojnë në një mënyrë të përshpejtuar dhe mund të lëshojnë udhëzime të përshtatshme për këtë formë procedimi.

Neni 26 Mosplotësimi i të metave

- 26.1 Nëse paditësi nuk paguan tarifat e caktuara për procedurat ose në rast të të metave të tjera siç përcaktohen nga DHKZK, kërkesa për arbitrazh konsiderohet se është tërhequr.
- 26.2 Nëse i padituri nuk i paraqet prapësimet e tij në përputhje me afatet e caktuara nga DHKZK, trupi gjykues mund të vazhdojë me arbitrazhin dhe të japë një vendim.

KREU 2 — Gjykimi në themel

Neni 27 Ligji i zbatueshëm për themelin

Trupi gjykues vendos për mosmarrëveshjen sipas rregullave të ligjit të zgjedhur nga palët ose, në mungesë të një zgjedhjeje të tillë, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Palët mund të autorizojnë trupin gjykues që të vendosë *ex aequo et bono*.

Neni 28 Vendimi

- 28.1 Vendimi do të merret me vendim të shumices, ose, sipas rastit, nga gjyqtari i vetëm.
- 28.2 Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën arsyetuese dhe pjesën urdhëruese (dispozitivin).

28.2.1 Në hyrjen e vendimit duhet të përmenden:

- a. Përbërjen e trupës së gjykimit dhe sekretarin, identitetin e tyre;
- b. Kohën dhe vendin e dhënies së vendimit;
- c. Palët, duke u shënuar identiteti i tyre si dhe përfaqësuesit;
- d. Objektin e kërkesës;
- e. Kërkimet përfundimtare të palëve.

28.2.2 Në pjesën arsyetuese duhet të përmenden:

- a. Rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit dhe përfundimet e nxjerra nga trupa gjyquese;
- b. Provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi;
- c. Bazën ligjore në të cilën bazohet vendimi.

28.2.3 Në pjesën urdhëruese (dispozitivin), duhet të përmenden:

- a. Çfarë vendosi trupa gjyquese;
- b. Kujt i ngarkohen shpenzimet e gjykimit;
- c. E drejta e ankimit, afati për paraqitjen e tij dhe organin ku mund të apelohej

28.2 Trupi gjyqës mund të vendosë t'ia komunikojë palëve vetëm dispozitivin e vendimit, përpara komunikimit të vendimit të arsyetuar. Vendimi do të jetë i zbatueshëm nga momenti i njoftimit të dispozitivit me shpalljen në seancë ose komunikimin me postë elektronike.

KREU 3 — E drejta e ankimit

Neni 29 Apelimi

29.1 Si mjet i fundit, vendimi i marrë nga DHKZK mund të apelohej pranë Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv, njohur nga FSHF, CAS Lozanë, Zvicër.

29.2 Afati kohor prej 21 ditëve për apelim, do të fillojë ditën që vendimi është marrë i plotë nga ana e Dhomës.

Neni 30 Përrjashtimi nga përgjegjësia

Me përrjashtim të rasteve kur anëtarët e DHKZK shfaqin sjellje me dashje, të papërshtatshme, ata dhe sekretariati i tyre nuk do të konsiderohen personalisht përgjegjës për veprimet e tyre dhe gabime në lidhje me procedurat.

Neni 31 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datë 01.06.2020 dhe shfuqizon Rregulloren e DHKZK të datës 01.03.2012

Presidenti
Armand DUKA

Sekretari i Përgjithshëm
Ilir SHULKU

ANEKSI NR.1
TARIFAT E SHERBIMEVE TE DHKZ

SHËRBIMI	TARIFA
Padi Arbitrazhi me vlerë deri në 5.000.000 Lekë	100.000 Lekë
Padi Arbitrazhi me vlerë mbi 5.000.000 Lekë	100.000 Lekë + 1.5% të diferencës mes 5.000.000 dhe vlerës së padisë.
Kërkesë për përcaktimin/konstatimin e statusit të lojtarit	30.000 Lekë
Lëshimin nga sekretaria të çdo kopje vendimi apo çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit Tërheqje	1000 Lekë